

# **IKAF AB-P3 Praktika në Auditimin e Brendshëm**

## **Syllabus dhe Udhëzues Studimi**

*Kualifikimi Auditor i Brendshëm i Certifikuar  
(Bazuar në Certifikimet IIA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

### **Struktura e Kualifikimit**

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Auditor i Brendshëm i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Praktika në Auditimin e Brendshëm. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

### **Moduli**

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregojnë në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojnë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

### **Struktura e Syllabusit**

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Praktika në Auditimin e Brendshëm i cili është pjesë e nivelit Auditor i Brendshëm i Certifikuar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

### **Udhëzuesi i Studimit**

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuar në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


## STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Auditor i Brendshëm i Certifikuar  
(Bazuar në Certifikimet IIA)*

Kualifikimi për auditim të brendshëm është kualifikim profesional për ushtrimin e detyrës në të gjithë sektoret ku nevojitet një intensifikim i njohurive në të gjitha aspektet e rolit të auditimit të brendshëm, menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes, në të cilat fusha operon auditori i brendshëm. Ndryshe nga kualifikimet tjera, ky kualifikim është i dizajnuar në mënyrë specifike për të bashkërenduar nevojat e auditimit të brendshëm dhe llogaritet si një benchmark për profesionin, bazuar në standardet e njohura ndërkombtarisht.

Përmbajtja e Kualifikimit është zhvilluar në atë mënyrë që të siguroj që kualifikimi ofron një sërë njohurishë, aftësishë dhe teknikash profesionale për auditor të brendshëm. Syllabusi është zhvilluar duke iu referuar kërkesës për këtë profesion, Kodit të etikës së Institutit për Auditim të Brendshëm (IAB/IIA), Standardeve Ndërkombëtare për Ushtrimin në Praktikë të Auditimit, dhe Kornizës për kompetencë për Auditim të brendshëm.


Kandidatët në Kualifikimin për Auditor i Brendshëm i Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulën “Praktika në Auditimin e Brendshëm”.



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Auditor i Brendshëm i Certifikuar

## Modulet

Kualifikimi Auditor i Brendshëm i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Auditor i Brendshëm i Certifikuar

### Kriteret e kualifikimit dhe anetaresimit: Auditor i Brendshëm i Certifikuar

- Diplomë Universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet dhe juridik apo dhe fusha tjera të studimeve relevante;
- Dëshmi për së paku tre (3) vite përvojë pune të verifikuar në auditim - që mund të përfitohet edhe gjatë apo pas trajnimit.
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Auditor i Brendshëm Çertifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “Auditor i Brendshëm i Çertifikuar” e kane obligative ndjekjen e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore te IKAF-it.

### Karakteristikat e ligjerates trajnuese:

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve, dhe gjatë ligjerates, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet IIA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjeruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet IAA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

# **STRUKTURA E SYLLABUSIT**

## **Arsyetimi**

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

## **Diagrami i relacioneve mes moduleve**

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

## **Qëllimi**

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

## **Aftësitë kryesore**

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

## **Temat**

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

## **Struktura e Ekzaminimit**

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

## **Shtojcë Syllabusi i Detajuar**

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

# MODULI

## Arsyetimi

Syllabusi mbi modulën Praktika mbi Auditimin e Brendshëm ndahet në disa kapituj dhe secili kapitull përbëhet nga temat e fushave të caktuara mësimore.

Praktika në  
Auditimin e  
Brendshëm

Diagrami.1.: Moduli

Pjesa e parë e modulit Praktika e Auditimit të Brendshëm njofton mbi aspektet dhe udhëzimet e detyrueshme nga Kornizën Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale (IPPF), kontrollin e brendshëm dhe konceptet e rrezikut, si dhe mjetet dhe teknikat për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm.

Kjo pjesë përbëhet nga tri seksione si: Udhëzime të detyrueshme, Kontrolli i Brendshëm dhe i Rrezikut, Kryerja e Angazhimeve të Auditimit të Brendshëm —Mjetet dhe Teknikat e auditimit.

Përveç kësaj, programi mësimor IAB jep udhëzime për thellësinë në të cilën ju duhet të dini temat. Ekzistojnë dy nivele: Aftësia: Kandidatët duhet të shfaqin aftësi (kuptim të plotë dhe aftësinë për të aplikuar konceptet). Ndërgjegjësimi (vetëdije): Kandidatët duhet të shfaqin vetëdije (njohuri për terminologjinë dhe bazat).

## Qëllimi

Dhënia e udhëzimeve të detyrueshme mbi Kornizën Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale (IPPF), kontrollin e brendshëm dhe konceptet e rrezikut. Më detajisht:

### Aftësitë kryesore

- Aftësimi i kandidatëve në kuptimin e plotë dhe aplikimin e koncepteve si dhe mjetet dhe teknikat për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm
- Ndërgjegjësimi mbi terminologjinë dhe bazat
- Përkufizimi i Auditimit të Brendshëm, qëllimi themelor, natyra dhe fushëvperimi
- Parimet dhe pritshmëritë e sjelljes së individëve dhe organizatave në kryerjen e auditimit të brendshëm
- Parimet dhe sigurimi i një kornize për kryerjen dhe promovimin e auditimit të brendshëm

## Temat

Temat kryesore të Modulit Praktika në Auditimin e Brendshëm që do të trajtohen gjatë ligjerates:

Udhëzuesit e detyrueshëm
Kodi i Etikës i IAB
Standardet Ndërkombëtare
Llojet e Kontrolleve
Teknikat e Kontrollit të Menaxhmentit
Karakteristikat & Përdorimi i Kornizës së Kontrollit të Brendshëm
Kornizat Alternative të Kontrollit
Konceptet dhe Fjalori i Rrezikut
Dokumentimi dhe Dokumentet e Punës
Procesi i Hartëzimit, Duke Përfshirë Diagramet
Vlerësimi i Rëndësisë, Mjaftueshmërisë, dhe Kompetencës së Dëshmive

Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulin Praktika në Auditimin e Brendshëm

### Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

### Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 2 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi dy orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

## **Syllabusi i Detajuar**

**Hyrje në Provim**

**Pjesa I – Udhëzime të detyrueshme – Hyrje**

**Udhëzuesit e Detyrueshëm**

**Hyrje në Standardeve**

**Llojet e Standardeve**

**Udhëzimet e rekomanduara fuqishëm**

**A. Përkufizimi i Auditimit të Brendshëm**

Qëllimi, Autoriteti, dhe përgjegjësia e aktivitetit të Auditimit të Brendshëm

Statuti i Auditimit të Brendshëm

Statusi organizativ i Aktivitetit të Auditimit të Brendshëm

Shërbimet e këshillimit

**B. Kodi i Etikës i IAB**

Kodi i Etikës i IAB

**C. Standardet Ndërkombëtare**

**C1. Në përputhje me Standardet e Atributit të IAB-së**

**C2. Ruajtja e Pavarësisë dhe Objektivitetit**

Pavarësia dhe Objektiviteti

Nxitja e Pavarësisë

Ndërveprimi i drejtpërdrejtë me Bordin

Nxitja e Objektivitetit

**C3-4. Ekspertiza dhe Aftësitë e Nevojshme**

**Standardi 1210: Ekspertiza**

**C5. Ushtrimi i Kujdesit të Duhur Profesional**

Standardi 1220: Kujdesi i Duhur Profesional

**C6. Promovimi i Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional**

**C7. Programi për Sigurimin e Cilësisë dhe Përmirësimit**

**1. Vlerësimet e Brendshme (Standardi 1311)**

**2. Vlerësimet e Jashtme (Standardi 1312)**

**Standardi 1320: Raportimi për Programin e Sigurimit të Cilësisë dhe Përmirësimit**

Standardi 1322: Zbulimi i Mospajtueshmërisë

**Seksioni II – Kontrolli i Brendshëm & Rreziku – Hyrje**

**A. Llojet e Kontrolleve (p.sh., Parandaluese, Zbuluese, Input, Output, etj)**

Definimi i Kontrollit

Klasifikimi i Kontrolleve

Afatet Kohore të Kontrolleve

Krijimi i procesit të kontrollit

Kufizimet e Kontrollit të brendshëm

## **B. Teknikat e Kontrollit të Menaxhmentit**

Monitorimi i Sistemit të Kontrollit

Kontrollet në Ciklet e Kontabilitetit

Cikli i të Ardhurave të Arkëtueshme

Cikli i Blerjeve-të Pagueshme

Cikli i Pagave

Cikli i Arkëtimit të Mjeteve Monetare

Cikli për Disbursimin e Parave të Gatshme

## **C. Karakteristikat & Përdorimi i Kornizës së Kontrollit të Brendshëm**

Modeli COSO

## **D. Kornizat Alternative të Kontrollit**

Modeli CoCo

Model Cadbury (Paraardhësja e Turnbull)

Reporti Turnbull

## **E. Konceptet dhe Fjalori i Rrezikut**

Terminologjia e Rrezikut

Procesi i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i Rrezikut Operacional

Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Ngulitja e Vetëdijes së Rrezikut në Kuadër të një Organizate

## **F. Vetdijësimi për Rrezikun e Mashtrimit**

Llojet e Mashtrimit

Kushtet e Nevojshme për të Kryer Mashtrim

Mashtrimet e Menaxhmentit

Përgjegjësia për Zbulimin e Mashtrimit

Kryerjen e një Hetimi për Mashtrim

## **Seksioni III – Kryerja e Angazhimeve të Auditimit të Brendshëm – Hyrje**

### **A. Grumbullimi i të dhënave**

A1. Anketimi Fillestar

A2. Listat kontrolluese dhe Pyetësorët

A3. Intervistimi

A4. Vëzhgimi

A5. Kryerja e Angazhimit për të Identifikuar Rreziqet Kryesore dhe Kontrollet

Llojet e Ekspozimeve të Rrezikut

Vlerësimi i Rreziqeve për Gjasat dhe Ndikimin

Hartëzimi i Rrezikut Bazuar në Gjasat dhe Ndikimi (impaktin)

Përgjigja ndaj rreziqeve

A6. Marrja e Mostrave

Përdorimet e marrjes së mostrave

Rreziku i Marrjës së Mostrave



Zgjedhja e Popullacionit të saktë

Përcaktimi i Madhësisë së Mostrës

Marrja e Mostrave të Atributit

Marrja e Mostrave Statistikore

Ballafaqimi me Gabimet në Mostër

Teknikat e Marrjes së Mostrave

Nxjerrja e Rezultateve të Mostrimit të Variablave në Popullacion

Marrja e Mostrës të Probabilitetit-Proporcional-për-Madhësinë (PPM)

## **B. Analiza dhe Interpretimi i Të Dhënave**

### **B1. Mjetet dhe Teknikat e Kompjuterizuara të Auditimit**

Nxjerrja e të Dhënave

Testimi i Sistemit Kompjuterik

Teknikat e Auditimit të Asistuar nga Kompjuteri (TAAK)

Metodat e tjera TAAK

### **B2. Analiza e Spreadsheet**

Përdorimi i Spreadsheet

Rreziku i Spreadsheet

### **B3. Teknikat e Rishikimit Analitik**

Identifikimi i Shkakut të Problemit

1. Krahasimet me buxhetin (Analiza e Variancës)

Variancat e Materialeve Direkte

2. Analiza e Trendit dhe Regresionit

3. Analizë Bazuar në Raportet Financiare

### **B4. Benchmarking**

Procesi i Benchmarking/Krahasimit

Llojet e Benchmarking

Kufizimet e Benchmarking

### **B5. Nxjerrja e konkluzioneve**

Rezultatet e angazhimit

Kriteret për Vëzhgimet dhe Rekomandimet

## **C. Raportimi i të Dhënave**

### **C1. Raportimi i Rezultateve të Testimit për Auditorin Përgjegjës**

### **C2. Zhvillimi i Konkluzionet Paraprake Lidhur me Kontrollin**

## **D. Dokumentimi dhe Dokumentet e Punës**

Funksioni i Dokumenteve të Punës

Përmbajtja e Dokumenteve të Punës

Dokumentet e Punës Kompjuterike ose Elektronike

Llojet e Dosje të Dokumenteve të Punës

Përmbledhjet në Dokumentet e Punës

Kontroli i Dokumenteve të Punës

Ruajtja e Dokumenteve të Punës

**E. Procesi i Hartëzimit, Duke Përfshirë Diagramet**

Diagramet

Diagrami i Rrjedhës së Të Dhënave

Narrativat

**F. Vlerësimi i Rëndësisë, Mjaftueshmërisë, dhe Kompetencës së Dëshmive**

Hierarkia e Besueshmërisë dhe Bindshmërisë së Dëshmive të Auditimit

**Aneksi A: Fjalori**

**Aneksi B: Mostra e Statutit të Aktivitetit të Auditimit të Brendshëm**

**Aneksi C: Këshillat mbi Praktikën për Programin e Sigurimit të Cilësisë dhe Përmirësimit**